



**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**

**RAPORT PARAPRAK (I NDËRMJETËM)
MONITORIMI I PROCESIT TË VOTIMIT NË 15 BASHKI TË VENDIT**

14 MAJ 2023

Publikuar në, dt.15 Maj 2023



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është një organizatë jofitimprurëse e pavarur dhe e paanshme që ka në misionin e saj promovimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, shtetin e së drejtës si dhe zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Në përputhje me misionin e saj, KShH ka një përvojë 27 vjeçare në monitorimin e proceseve zgjedhore parlamentare dhe të qeverisjes vendore që janë mbajtur në vendin tonë.

Me një ekip prej 30 vëzhguesish afatgjatë, të trajnuar sipas një metodologjie që bazohet në parimin e objektivitetit dhe paanshmërisë, KShH është angazhuar fillimisht në monitorimin e procesit parazgjedhor dhe klimës së këtij procesi, për të cilën ka ndarë raportin e parë të ndërmjetëm të monitorimit, të aksesueshëm në këtë link:

[Final Raport-i-Ndermjetem Procesi-Parazgjedhor 12-Maj-2023 Komiteti-Shqiptar-i-Helsinki.pdf \(ahc.org.al\)](https://www.ahc.org.al/Files/Final%20Raport-i-Ndermjetem%20Procesi-Parazgjedhor%2012-Maj-2023%20Komiteti-Shqiptar-i-Helsinki.pdf)

Në këtë raport të dytë të ndërmjetëm, KShH ka pasqyruar gjetjet dhe konkluzionet paraprake të monitorimit që i përkojnë periudhës 13, 14 dhe pjesërisht 15 Maj 2023, ditë përgjatë të cilave kemi vëzhguar respektimin e heshtjes zgjedhore, dorëzimin e materialeve nga KQZ tek KZAZ, e këto të fundit drejt KQV-ve, procesin e votimit dhe pjesërisht të numërimit.

KShH do të dalë në vijimësi me një raport përfundimtar, ku do të përpunohen në mënyrë më të plotë të gjitha të dhënat dhe pasqyrohen gjetjet dhe konkluzionet tona përfundimtare bashkarisht me rekomandimet përkatëse, përfshi ato të natyrës legjislative drejtuar Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës Zgjedhore pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Veprimtaria e këtij Komisioni që nga ngritja e tij ka rezultuar e munguar.

Monitorimi i këtyre zgjedhjeve po realizohet në kuadër të nismës “Ndërtimi i integritetit elektoral dhe qëndrueshmërisë së partive politike: Rritja e rolit mbikëqyrës dhe kërkesave të qytetarëve nëpërmjet mbështetjes së OShC-ve, mediave dhe akademisë”, mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Tiranë. Kjo nismë po zbatohet nga një konsorcium organizatash vendase, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti i Studimeve Politike, Qëndresa Qytetare, BIRN Albania.

Gjetjet dhe konkluzionet e pasqyruara në këtë raport janë përgjegjësi e vetme e KShH-së dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht opinionet dhe mendimet e organizatave të tjera partnere dhe Ambasadës Britanike në Tiranë.

Përmbledhje e Gjetjeve Kryesore

Gjatë procesit të votimit dhe numërimit, vëzhguesit e KShH-së e shtrinë monitorimin në 200 Qendra Votimi në 15 Bashki të Vendit, përkatësisht në Shkodër, Dibër, Malësi e Madhe, Kukës, Lezhë, Tiranë, Kamëz, Durrës, Elbasan, Pogradec, Korçë, Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastrë. Ndërkohë ka filluar procesi i monitorimit të numërimit të votave në 9 VNV, proces ky i cili do të shtrihet gjatë orëve në vijim në të gjitha Bashkitë objekt monitorimi.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Pjesëmarrja e zgjedhësve në këto votime, deri në orën 19:00 të ditës së djeshme raportohet në masën 37.79% nga KQZ, për 3619 QV nga një total prej 5213 QV në rang vendi. Më herët, KShH ka raportuar nga të dhënat me kontaktet e realizuara me zgjedhësit në terren se vihet re një klimë e lartë apatie ndaj partive politike dhe zgjedhjeve, pasi zgjedhjet e mbajtura ndër vite nuk kanë sjellë zgjidhje ndaj kushteve të vështira sociale ekonomike në të cilat jetojnë një pjesë e popullsisë, ndërkohë që raportohet si shqetësues fenomeni i largimit të të rinjve jashtë vendit.

Si rrjedhojë edhe e gjuhës së ashpër dhe me elementë urrejtje gjatë fushatës zgjedhore, më së shumti midis drejtuesve të forcave politike garuese, klima e përgjithshme ditën e votimit nisi me tensione, për shkak të disa incidenteve të ndodhura e të raportuara edhe në media, që në orët e para të mëngjesit në Bashkitë Kolonjë, Maliq, Durrës, Fushë Krujë, Lezhë, etj. Lidhur me to, rezultojnë sipas medias se shërbimet e Policisë së Shtetit kanë referuar menjëherë ngjarjet pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore.

Në orët e para të mëngjesit procesi ka filluar me vonesë ose është ndërprerë, duke krijuar konfuzion tek zgjedhësit, për shkak të mosvënies apo ndërprerjes së funksionimit të pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësit, për një pjesë të QV të vëzhguara, më së shumti në QV në Bashkitë Tiranë, Elbasan, Gjirokastrë dhe Vlorë. Vonesë në fillimin e procesit ka patur edhe për shkak të marrjes me vonesë të bazës materiale nga QV e disa Bashkive, mungesës së njohurive të duhura të anëtarëve të KQV për veprimet përgatitore apo vakancave të krijuara në përbërjen e këtyre Komisioneve, kryesisht nga subjekti zgjedhor "PD".

Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve¹, për kalimin nga identifikimi elektronik nëpërmjet sistemit PEI në vijimin e procesit të identifikimit të zgjedhësve në mënyrë manuale në rreth 533 QV (afro 10% e totalit të QV), u mor në orën 09:00, dhe i është dërguar dorazi për njohje KQV-ve ku procesi është bllokuar rreth orës 9:24². Në vlerësimin e KShH-së ky ishte një vendim i duhur, por i vonuar. Lidhur me këtë situatë dhe duke marrë parasysh kostot e pajisjeve elektronike të këtij procesi zgjedhor, KShH i sugjeron KQZ-së, të analizojë në mënyrë të plotë shkaqet dhe të mundësohet identifikimi i përgjegjësive dhe marrja e masave ndaj personave përgjegjës, nëse është rasti.

Në tërësi, vëzhguesit e KShH-së raportuan se KQV-të respektojnë procedurat e votimit për zgjedhësit. U vërejt një ndarje e roleve midis Komisionerëve sa i takon respektimit të detyrimeve të parashikuara në nenin 40 të Kodit Zgjedhor, për verifikimin e emrit të zgjedhësit në listë, kontrollit të mjetit identifikues ID dhe nënshkrimit të zgjedhësit në listë, timbrosjes në gishtin e madh të njëjës dorë dhe dhënies së dy fletëve të votimit të vulosura nga mbrapa.

Vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar raste konkrete të problemeve sistematike të procesit zgjedhor, të përsëritura edhe në zgjedhjet e kaluara të lidhura. Janë adresuar prej tyre 36 vërejtje me shkrim sa i takon rasteve të votimit familjar, mos respektimit të procedurave për dhënien e ndihmës ndaj zgjedhësve që për shkak të aftësive të veçanta nuk mund të votojnë

¹ Nr. 520 dt. 14.05.2023

² QV 1827/1 tek Petro Nini (Bashkia Tiranë)



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

vetë, prezencën e personave të paautorizuar në Qendrat e Votimit, për përdorim ose mbajtje të aparatit celular nga ana e zgjedhësve, në kundërshtim me nenin 109 pika 2 të Kodit Zgjedhor, për lejimin e fotografimit të votës dhe mos raportim nga ana e KQV-së pranë organeve proceduese, për mungesë verifikimi paraprak të timbrosjes dhe në disa raste mos timbrosje të zgjedhësve.

Problematika lidhur me çështje të votimit familjar dhe mos ndjekjes së procedurave për zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë, janë konstatuar në total 15 raste, përkatësisht në Bashkinë Pogradec³, Berat⁴, Dibër⁵, Elbasan⁶, Lezhë⁷, Tiranë⁸ dhe Malësi e Madhe⁹, ku janë raportuar mosrespektim të detyrimeve të parashikuara në nenet 106 dhe 108 të Kodit Zgjedhor.

Janë depozituar në total 5 vërejtje me shkrim për përdorim të telefonisë celulare, në cenim të nenit 109, pika 2 të Kodit Zgjedhor në Bashkinë Pogradec¹⁰, Dibër¹¹, Korçë¹². Sa i takon mostimbrosjes së zgjedhësve dhe timbrosjes jo në përputhje me parashikimet e nenit 105 të Kodit Zgjedhor, janë depozituar 7 vërejtje me shkrim në Bashkitë Kukës¹³, Pogradec¹⁴, Tiranë¹⁵.

Ndërkohë që në tërësi, vëzhguesit partiakë përfaqësues të subjekteve të mëdha zgjedhore, patën kryesisht një qasje joreaguese ndaj problematikave sistematike të procesit të votimit, duke shfaqur një klimë mirëkuptuese dhe në disa raste bashkëpunuese me njëri tjetrin dhe Komisionerët e QV-ve. Ata u fokusuan më së shumti në identifikimin dhe raportimin me anë të aplikacioneve dhe formateve të printuara tabelore, të zgjedhësve që vendosën t'i drejtoheshin QV për të votuar, informacion të cilin e morën kryesisht nga relatimi që bënë Komisionerët drejt tyre, me zë të lartë, sa i takon numrit rendor të zgjedhësve. KShH vuri në dijeni lidhur me këtë fakt, KQZ-në, duke komunikuar se raportime të tilla të cilat identifikojnë zgjedhësit, kur bëhen aty për aty dhe në bashkëpunim midis vëzhguesve dhe operatorëve të PEI apo Komisionerëve, krijojnë premisa të dëmshme të presioneve potenciale (psh identifikohen jo votuesit) dhe rrjedhimisht edhe të cenimit të integritetit të procesit.

Gjithashtu, KShH ka sinjalizuar në mënyrë të vazhdueshme shkelje të veçanta apo në grup pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si organi më i lartë i administrimit zgjedhor, duke i kërkuar marrjen e masave parandaluese dhe reaguese. KQZ ka konfirmuar marrjen e këtyre komunikimeve por ka reaguar menjëherë vetëm në një rast, duke bërë thirrje publike për

³ QV 3885/03;

⁴ QV 3311

⁵ QV 1176; QV 1142

⁶ QV 2322

⁷ QV 0737 dy herë, QV 0687

⁸ QV 2076/00, 2110, 2061/00, 2116, 2052/01. 1895/00

⁹ QV 0025

¹⁰ QV 3700/00

¹¹ QV 1142

¹² QV 3674, 3692, 3684/00

¹³ QV 0640/00 (timbrosje në dorën e djathtë)

¹⁴ QV 3906/1; QV 3886/00 (timbrosje në dorën e djathtë)

¹⁵ QV 0037/1 (moskontrollim për timbrosje), 1645/00, 1645/01 (timbrosje në dorën e djathtë), 2090 (mungon timbrosja)



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

largimin e personave të paautorizuar nga QV. Ky reagim nuk i shërbeu parandalimit të episodeve të tjera të prezencës së këtyre shtetasve, të cilët, në disa QV u rikthyen edhe pasi u larguan pak më parë nga forcat e policisë (sikurse ishte rasti i Shkollës Naim Babameto në Durrës).

Në tërësi, aksesit i vëzhguesve në QV-të e monitoruara ishte i mirë. Megjithatë, pati disa raste kur ata u ndeshën me pengesa, presion apo sjellje intimiduese nga Komisionerët dhe vëzhguesit partiakë në Bashkitë Lezhë, Kukës, Gjirokastrë, Berat¹⁶. Në Bashkinë Lezhë, në kundërshtim me nenin 7 pika 1.b i Kodit Zgjedhor, KQV nuk ka pranuar të protokollojë vërejtjen me shkrim që ka paraqitur vëzhguesi ynë për shkak të prezencës së votimit familjar. Në shkelje flagrante, komisionerët i kanë dorëzuar vërejtjen vëzhguesit të subjektit zgjedhor PS, i cili e ka fotografuar dhe dërguar atë në *whatsapp*. Në vijim, vëzhguesi i KShH-së është ndjerë i intimiduar dhe është larguar nga kjo QV¹⁷. Sinjalizimet për pengesë aksesit të vëzhguesve të tij, KShH ja ka përcjellë në mënyrë sistematike KQZ-së.¹⁸

● Heshtja Zgjedhore

Vëzhguesit e KShH-së konstatuan se subjektet zgjedhore, përfaqësues të forcave politike kryesore në vend nuk respektuan heshtjen zgjedhore. Ndërkohë vlerësohet transparencja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për raportimin ndaj publikut të shqyrtimit të 29 denoncimeve për thyerje të heshtjes zgjedhore. Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e garantimit të mos ndikimit të vullnetit të zgjedhësve në orët e fundit të garës ndërmjet subjekteve politike, KQZ mendojmë se duhet të shqyrtojë në kohë të arsyeshme denoncimet e adresuara për cenim të heshtjes zgjedhore dhe nëse janë kushtet të vendosë masat administrative sipas nenit 174 të Kodit Zgjedhor.

Nga vëzhgimet në terren në disa lagje të Bashkive të monitoruara, gjatë pjesës së parë të ditës së datës 13 Maj 2023, vëzhguesit e KShH-së kanë vënë re prezencën e materialeve propagandistike statike apo të lëvizshme nga subjekte zgjedhore të ndryshme, në formatet postera, *billboards* (ekrane elektronike) dhe fletushka të lëna masivisht në makinat e parkuara në rrugë. Shkelje të nenit 77 të Kodit Zgjedhor janë evidentuar në bashkitë e Elbasanit, Shkodrës, Tiranës, Kukësit, Lezhës, Durrësit, Beratit, Pogradecit, Gjirokastrës, Vlorës e Shkodrës. KShH i sugjeroi KQZ-së të urdhërojë Policinë Bashkiake dhe/ose Policinë e Shtetit të garantojnë zbatimin e neneve 77/2, 79, dhe 174 të Kodit Zgjedhor, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore.

¹⁶ Janë regjistruar në QV nr. 0687, KZAZ nr. 12 në Bashkinë Lezhë dhe në QV nr. 3273, KZAZ nr. 65 në Bashkinë Berat, në QV 0652/00, KZAZ 11 Bashkia Kukës, QV 4262/1, KZAZ 80 Bashkia Gjirokastrë

¹⁷ Vëzhguesi i këtij subjekti i është drejtuar vëzhguesit të KShH me emër dhe tone të larta, duke i kujtuar se ky është rasti i dytë që krijon situata të tilla.

¹⁸ Raste të tjera u konstatuan në QV 0732/1 (ZAZ 12) në Bashkinë Lezhë, nuk është lejuar qasja e vëzhguesit të KShH-së për të ndjekur veprimet parapërgatitore të KQV-së. Në rastin e Bashkisë së Beratit në QV 3273/00 (ZAZ 65), në procedurat e mbylljes së procesit të votimit, vëzhgueses së KShH-së i është kërkuar të dalë jashtë dhe është kërkuar ndihma e punonjësve të policisë, të cilët kanë refuzuar ta bëjnë këtë veprim. Në QV 0652/00 (ZAZ 11) në Bashkinë Kukës është konstatuar se anëtarët e KQV-ve janë përpjekur të intimidojnë vëzhguesen e KShH-së duke e udhëzuar të raportojë vetëm gjëra pozitive për këtë QV. Në QV 4262/1 (ZAZ 80) Bashkia Gjirokastrë vëzhguesja e KShH është nxjerrë jashtë në procesin e mbylljes së procesit të votimit.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nga ana e KQZ në datën 13 Maj 2023, në vijim të sinjalizimit të realizuar nga KShH, është publikuar vendimi nr.526 për heqjen e gjithë materialeve propagandistike nga të gjitha ekranet led-wall (billboards) në afërsi të KQV-ve, KZAZ-ve dhe VNV-ve, duke ngarkuar me detyrimin e zbatimit të kësaj vendimmarrje subjektet zgjedhore, Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake. Ditën e votimit në datën 14 Maj është raportuar për ndërhyrjen e policisë për heqjen e materialeve propagandistike në ambientet e jashtme të zyrës elektorale të partisë Lëvizja Bashkë, kryetari i së cilës kandidon për kryetar i Bashkisë Tiranë. Megjithatë kjo ndërhyrje nuk rezultoi të jetë bërë edhe për subjektet e tjera zgjedhore, të cilat sipas konstatimeve të vëzhguesve të KShH-së, materialet e tyre propagandistike kanë vazhduar të qëndrojnë të afishuara në ambiente të ndryshme nëpër qytet.

Në tërësi, KShH vlerëson se vendimmarrja e KQZ për urdhërimin e heqjes së materialeve propagandistike duhet të ishte me e hershme në kohë, në orët e para të mëngjesit të dt.13 Maj dhe kërkonte mbikqyrje sistematike të zbatimit të urdhërimeve të saj, nga Policia e Shtetit dhe Policinë Bashkiake.

Vëzhguesit e KSHH-së kanë konstatuar postime në rrjete sociale apo nëpërmjet mesazheve telefonike të kandidatëve të ndryshëm për anëtarë të këshillit bashkiak në bashkitë e Dibrës, Tiranës, Vlorës, Lezhës. Janë evidentuar edhe raste të disa mediave online të cilët kanë publikuar rezultate të sondazheve të realizuara për kandidatë për kryetar bashkie në bashkinë e Pogradecit. Por mediat online, jashtë sferës së mbikqyrjes së AMA-s sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Gjatë ushtrimit të së drejtës së votës ditën e votimit, në kundërshtim me kërkesat e heshtjes zgjedhore, përfaqësues të partive politike ose kandidatë për këto zgjedhje kanë bërë deklarata që teksa pozitivisht kanë nxitur pjesëmarrjen e shtetasve në votime, indirekt, përmëbanin mesazhe politike propaganduese për të votuar kandidatët përfaqësues të subjektit të tyre zgjedhor.

• Transferimi i materialeve zgjedhore pranë QV

Në kuptim të nenit 99 të Kodit Zgjedhor¹⁹, procesi i shpërndarjes së materialeve fillon me dërgimin e tyre nga KQZ-ja pranë selive të KZAZ-ve, hap i cili duhet të kishte përfunduar më datë 11 Maj 2023, tri ditë përpara Ditës së Votimit. Ndërkohë, KShH verifikoi në terren se pranë disa KZAZ-ve të Bashkisë Tiranë dhe Durrës²⁰, ky proces i rëndësishëm u realizua me vonesë, vetëm në pasditen e datës 12 Maj apo në orët e para të mëngjesit të datës 13 Maj. Në këto kushte, komisionerët e KZAZ-ve janë vërejtur teksa punonin në kushte të një mbingarkese të sforcuar e, kësisoj, ishin të tensionuar. Vlen të përmendet se KQZ ka parashikuar datën 12 Maj 2023 si datën e përfundimit të këtij procesi²¹, në cenim të afatit ligjor.

Hapi i dytë i procesit konsiston në përcjelljen e materialeve nga KZAZ-të pranë KQV-ve, proces i cili në kuptim të nenit 100 të Kodit Zgjedhor duhet të përfundonte, jo më vonë se 15

¹⁹ KQZ-ja dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve, materialet zgjedhore, të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi (QV), ndër të tjerash, numrin e nevojshëm të fletëve të votimit, vulën e KQV-së, procesverbalet e qendrës së votimit, librin e protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, zarfet përkatëse për fletë votimi të dëmtuara, papërdorura, lëndën e posaçme të timbrimit, etj.

²⁰ KZAZ 23, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39 dhe 40

²¹Referuar Planit të Veprimit 2022-2023: Detyrat e Procesit Zgjedhor 2023, i aksesueshëm në këtë link: https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2022/12/kqz_221117_pdf_detyrat_2023.pdf



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

orë para hapjes së votimit, pra jo më vonë se ora 16.00 e dt.13 Maj. Asnjë prej KZAZ-ve të Bashkive të monitoruara nuk ka përmbyllur këtë proces brenda orarit, si rrjedhojë e vonesave të marrjes në dorëzim të materialeve dhe problematikat e krijuara në vakancat dhe zëvendësimet e propozuara nga subjektet zgjedhore për anëtarësinë e KQV-ve²².

Për problematikat e konstatuara me dorëzimin me vonesë të materialeve zgjedhore, fillimisht drejt KZAZ-ve dhe më pas KQV-ve, KShH ka raportuar pranë KQZ-së, duke kërkuar marrjen e masave që ky proces të mbyllet në kohë. Por të dhënat e mëtejshme të monitorimit treguan se afatet jo vetëm nuk u respektuan, por pati KZAZ që përfunduan procesin e dorëzimit materialet drejt KQV-ve në mesnatën e dt.13 Maj apo orët e para të mëngjesit të ditës së votimit.²³

Si rrjedhojë e këtyre vonesave, u vërejtën mangësi në drejtim të plotësisë materialeve zgjedhore, sikurse ishte rasti i QV 3909/01 të Bashkisë Fier (ZAZ nr. 58). Referuar Vendimit nr. 522, dt. 14.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në këtë QV u konstatuan se mungonin 250 fletësh votimi, të cilat u morën nga QV-ja pranë, me nr. 3209/00. Ndërkohë vëzhguesit e KShH-së raportuan se QV 3209/01 ka patur një mungesë prej 500 fletësh votimi, duke patur fillimisht në dispozicion vetëm 5 të tilla. Në kushtet kur QV nr. 3209/01 ka një numër total prej 496 zgjedhësish, KShH i sugjeroi KQZ-së të merren masa për pajisjen e saj me numrin e nevojshëm të fletëve të votimit sipas numrin të zgjedhësve përkatës²⁴.

● Klima e Përgjithshme dhe Rendi Publik

Si rrjedhojë edhe e gjuhës së ashpër dhe me elementë urrejtje gjatë fushatës zgjedhore, më së shumti midis drejtuesve të forcave politike garuese, klima e përgjithshme ditën e votimit nisi me tensione, për shkak të disa incidenteve të ndodhura që në orët e para të mëngjesit. Prej orës 06:37 është shënuar incidenti i parë në Bashkinë e Kolonjës, ku një simpatizant i subjektit politik PD raportohet se ka goditur kryebashkiakun e rikandiduar të subjektit zgjedhor “PS”, z. Erion Isai.²⁵

Rreth orës 10:50 u ndërpre procesi i votimit në QV 1430/2 në Bashkinë Durrës, pas një konfrontimi fizik ndërmjet mbështetësve të dy forcave politike dhe sekretari të KQV-së, ky i fundit i propozuar nga ana e subjektit politik “Koalicioni Bashkë Fitojmë”. Sekretari është larguar duke marrë vulën me vete, shkak që ka bërë që procesi i votimit të ndërpritej për 30 minuta.²⁶

²² KZAZ-të 73 dhe 74 (Bashkia Korçë, propozuar ndryshimi nga subjektet zgjedhor PD dhe koalicioni BF), Bashkia Dibër (KZAZ 19, propozuar ndryshimi nga subjekti zgjedhor koalicioni BF), KZAZ 84 dhe 86 (Bashkia Vlorë, propozuar ndryshimi nga subjekti zgjedhor koalicioni BF), KZAZ 1 (Bashkia Malësi e Madhe, propozuar ndryshimi nga subjektet zgjedhore PS, PD, koalicioni BF), KZAZ 59 (Bashkia Fier, propozuar ndryshimi nga subjekti zgjedhor PD), KZAZ 12 dhe 13 (Bashkia Lezhë, propozuar ndryshimi nga subjekti zgjedhor PD)

²³ KZAZ 1 në Bashkinë e Malësisë së Madhe; KZAZ 80 në Bashkinë e Gjirokastrës

²⁴ Sipas të dhënave publike në faqen e KQZ.

²⁵ <https://top-channel.tv/2023/05/14/zgjedhjet-nisin-me-dhune-goditet-kryebashkiaku-i-kolonjes-erion-isai-simpatizanti-i-bashke-fitojme-shoqerohet-ne-rajon-emril/>

²⁶ <https://top-channel.tv/2023/05/14/nderpritet-votimi-ne-nje-qender-ne-durres-pas-nje-sherri-iken-sekretari-dhe-merr-me-vete-vulen8/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Harku kohor mes orës 11:00 - 13:00 ka shënuar dy incidente fizike në zonën e Fushë-Krujës dhe të Maliqit. Fillimisht ka qenë një zgjedhës i cili ka goditur anëtarin e njëjës KQV. Sipas informacionit zyrtar të ndarë nga ana e Policisë së Shtetit, mendohet se shkak i debatit ka qenë radha e votimit.²⁷ Ndërkohë, në Bashkinë e Maliqit, deputeti i subjektit politik PD ka rënë preh e një sulmi fizik nga ana e një grupi të rinjsh simpatizantë.²⁸

Gjithashtu, në QV 1430/00 (ZAZ 24) Bashkia Durrës, është sinjalizuar incidenti ndërmjet disa shtetasve mes të cilëve kreu i subjektit politik PD dhe këshilltarit bashkiak të PS-së. Edhe pse ky incident u regjistrua rreth orës 13:00, u vërejt se rreth 4 orë më pas, mbështetësit e subjekteve të ndryshme zgjedhore vazhdonin të ishin të pozicionuar në ambientet e jashtme të murit rrethues të shkollës Neim Babameto që shërben si qendër votimi (duke u rikthyer pas shpërndarjes që ka bërë më herët Policia e Shtetit).

Rreth orës 18:00, raportohet se ish kreu i Njësisë Administrative Shëngjin (Bashkia Lezhë), ka depozituar një kallëzim, duke pretenduar se dy automjete i kanë prerë rrugën, ndërkohë që një prej autorëve të dyshuar mbante në dorë një armë zjarri.

Lidhur me disa prej çështjeve të sipërcituara, është konstatuar se shërbimet e Policisë së Shtetit kanë referuar menjëherë ngjarjet pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, të cilat po ndërmarrin veprimet paraprake hetimore.

● **Ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe pjesëmarrja në votime**

Vëzhguesit kanë raportuar, se në shumicën e rasteve, zgjedhësit nuk kanë qenë të ndërgjegjësuar për emrin e tyre në listë, mbi mënyrën e votimit, pra sa i përket fletëve të votimit që duhet të plotësonin, si dhe hedhjen e tyre në kutitë përkatëse të votimit. Duke qenë se në një pjesë të godinave ishin vendosur disa QV, shpesh herë u konstatuan zgjedhës që shkonin sa tek njëra te tjetra, të cilët ndihmoheshin për identifikimin e Qendrës së tyre, si nga Komisionerët, operatorët e PEI por dhe vëzhguesit partiakë.

Në Bashkitë Elbasan dhe Kamëz, dy nga Bashkitë në të cilat u pilotua procesi i votimit elektronik, u vërejt se komunitetet e marginalizuara të shoqërisë kryesisht ata rom-egjiptian, të moshuar, ose personat me aftësi të kufizuara, nuk ishin të informuar mbi mënyrën e votimit. Mungesa e ndërgjegjësimit të zgjedhësve, ka ndikuar në rritjen e numrit të rasteve të ndihmës së ofruar zgjedhësve nga ana e familjarëve të tyre dhe atyre të votimit familjar, për të cilat nuk është garantuar respektimi i pikës 3 të nenit 106 të KZ që parashikon se çdo zgjedhës voton vetë, nga KQV-të e monitoruara.

● **Hapja dhe fillimi i procesit të votimit**

Bazuar në nenin 11 pika 1 të Kodit Zgjedhor, procesi i votimit duhej të fillonte në orën 7:00 të datës 14.05.2023, por ky orar nuk u respektua në shumicën e KQV-të të monitoruara në

²⁷<https://ëëë.balkanëeb.com/incident-ne-nje-qender-votimi-ne-fushe-kruje-persona-te-paidentifikuar-nxjerrin-me-dhune-komisionerin-e-opozites/>

²⁸<https://ëëë.balkanëeb.com/je-i-lidhur-me-bandat-edmond-spaho-goditet-me-grusht-pas-akuzave-per-deputetin-e-ps-kallezim-ne-prokurori-ja-cfare-ndodhi-ne-maliq/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

15 Bashkitë respektive. Në QV-të e disa Bashkive²⁹ u vërejtën vonesa në hapjen e procesit të votimit dhe lënia në pritje e zgjedhësve, si rrjedhojë e mungesës së njohurive të duhura të Komisionerëve për veprimet parapërgatitore. Kjo vuri në pikëpyetje cilësinë e trajnimit të tyre apo pjesëmarrjen e plotë të tyre në trajnime, për të cilat, më herët KShH kishte konstatuar mungesën e një mekanizmi të dokumentimit dhe mbikëqyrjes së pjesëmarrjes në trajnimet e zhvilluara nga KQZ. Si rrjedhojë e të njëjtës problematikë, ka patur QV të cilat nuk janë vulosur me etiketën e sigurisë, por kyçur me çelës³⁰.

Konfuzion ka shkaktuar mosfunksionimi i rregullt dhe në disa raste apo mosvënia në funksion total i pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësit, për një pjesë të QV të vëzhguara, më së shumti në QV në Bashkitë Tiranë, Elbasan, Gjirokastër dhe Vlorë.³¹

Shkak i fillimit me vonesë të procesit ka qenë edhe mungesa e anëtarëve në disa KQV, nga radhët e subjekteve zgjedhore “Partia Demokratike” dhe “Partia Social Demokratike”, në Bashkitë Malësie e Madhe³², Korçë³³, Fier³⁴ dhe Kukës³⁵. Në një pjesë të QV, kjo ka sjellë vijueshmërinë e punës me anëtarët që formonin shumicën e anëtarësisë, konform nenit 29 pika 8 të Kodit Zgjedhor.

- **Prania e personave të paautorizuar gjatë ditës së votimit**

Sipas nenit 109, pika 6 të Kodit Zgjedhor, në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj dhe në korridoret e brendshme të ndërtesës nuk lejohet prania apo grumbullimi i personave, përveç zgjedhësve që presin në radhë për të votuar. Deri në një rreze prej 150 m, prezenca e personave të paautorizuar është e ndaluar sipas Urdhërit të KQZ-së nr.62, dt. 03.05.2023³⁶.

²⁹ Bashkisë Tiranë si ato nr. 2105/00 (ZAZ 29), nr. 1858/00 (ZAZ nr. 36), Bashkisë Gjirokastër QV 4252/00 (ZAZ 80), Bashkisë Korçë QV 3641/00 (ZAZ 74), dhe Bashkisë Berat QV 3273/02 (ZAZ 65), Bashkisë Durrës QV 1472/01 (ZAZ 23).

³⁰ Në QV 1176/00 (ZAZ 19) në Bashkinë Dibër, votimi ka filluar me një vonesë prej 29 min, për shkak se dera në QV nuk është konstatuar e vulosur me etiketën e sigurisë. Anëtarët e KQV-së duke mos pasur dijeni për zëvendësimin e plastelinës vulosëse me etiketën e sigurisë, kanë konstatuar mungesën e saj me procesverbal, në mungesë të dijenisë mbi materialet e ndryshuara.

³¹ Bashkinë Tiranë QV nr. 2077/00 (ZAZ 30), 1827/01 dhe 1827/02, 1828/02, 1829/00 dhe 1829/1 (ZAZ 35), 1857/00, 1857/01 dhe 1857/02 (ZAZ 36), votimi ka filluar me vonesë (rreth orës 10:00) pas publikimit të vendimit nr. 520, dt. 14.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, një vendimmarrje e cila zhbllkoi procesin duke e rikthyer atë në manual. E njëjta situatë është vërejtur në Bashkitë Elbasan QV 2307/00 (ZAZ 48), Bashkinë Gjirokastër QV 4258/01 (ZAZ 80) ku operatori ngatërroi kodet e pajisjes dhe QV 4240/00, Bashkinë Vlorë QV 4493/01 (ZAZ 86).

³² QV 0047/01 (ZAZ 1) procesi i votimit ka filluar në orën 07:20, pas ardhjes së anëtarit të subjektit politik Partia Social Demokratike (PSD).

³³ QV 3669/01 (ZAZ 74) dhe QV 3676/00 (ZAZ 74) u konstatua mungesa e anëtarit të forcës politike Partia Demokratike (PD) dhe atij të PSD-së, fakt për të cilin u vu në dijeni KZAZ.

³⁴ Mungesë vetëm e anëtarit të PD-së u vërejt në QV 3020/00 dhe 3032/01 (ZAZ 59) në Bashkinë Fier

³⁵ QV 0646/00 (ZAZ 11), votimi ka nisur 20 minuta me vonesë si pasojë e mungesës së dy komisionerëve të subjektit zgjedhor PD. Njëri prej tyre nuk është paraqitur, dhe pas disa minuta pritjeje dhe tentativa të pasuksesshme për ta kontaktuar, procesi i votimit ka nisur pa praninë e tij.

³⁶ Konkretisht parashikohet ndalimi i qëndrimit dhe/ose të grumbullimit në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj, në korridoret e brendshme të ndërtesës ku është/janë të vendosura qendrat e votimit dhe përreth tyre në një distancë rrethore me rreze më të vogël se 150 m, të personave të tjerë, përveç atyre të përcaktuar në pikën 1, të këtij urdhri (anëtarët e KQV, Zgjedhësit në radhë për të votuar, Vëzhguesit e



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Përgjatë gjithë ditës së votimit vëzhguesit e KShH në 14 nga 15 Bashki të monitoruara, raportojnë prezencë të personave të paautorizuar, pa bexhë akredituese që vëzhgojnë procesin ose qëndrojnë në ambientet e brendshme (korridore dhe në hyrje të godinës) e të jashtme (në pjesën e oborrit të godinave apo në afërsi të mureve/gardheve rrethuese) të KQV-së³⁷. Ndër ta, u raportuan edhe kandidatë të këshillave bashkiakë dhe drejtues të subjekteve zgjedhore në Bashkitë respektive³⁸.

Një prej këtyre rasteve flagrante është konstatuar nga pranë shkollës Neim Babameto në Bashkinë Durrës (QV 1429,1430,1430/1), ku u vërejt shumë persona të paautorizuar, afër murit rrethues të saj si dhe debate me tona të ashpra dhe ofendime midis dy grupimeve politike. Policia më pas ka bërë shpërndarjen e këtyre personave të grumbulluar. Kjo klimë e ashpërsuar ka sjellë edhe një përplasje fizike, në rrezen e ndaluar të qëndrimit në godinat e QV-ve, midis kandidatës së këshillit të bashkisë Durrës të subjektit PD që raportohet se ka goditur në fytyrë kandidatin e Këshillit të Bashkisë të subjektit zgjedhor PS,. Policia është lajmëruar lidhur me këtë ngjarje, ndërkohë që procesi i votimit nuk është pezulluar nga ana e KQV-së, ashtu siç parashikohet në pikën 4 të Urdhërit nr.62, date 03.05.2023 të KQZ.

Personat e paautorizuar në përgjithësi vëzhgonin zgjedhësit që hynin dhe dilnin nga QV si dhe i orientonin ata për të identifikuar QV edhe nëpërmjet E-Albania.³⁹ Në disa raste personat e autorizuar janë vëzhguar duke mbajtur lista zgjedhësish në duar⁴⁰. Këta individë janë identifikuar nga ana e vëzhguesve të KShH edhe si përfaqësues së institucioneve publike.⁴¹ KShH i komunikoi KQZ-së se Komisionerët e QV-ve neglizhojnë ose janë shumë pasive për të verifikuar ambientet në korridoret dhe oborret e godinave ku janë vendosur personat e paautorizuar. Megjithatë, ka pasur edhe raste të tjera kur këta individë janë orientuar të largohen, sidomos pas evidentimit të faktit të prezencës së tyre nga ana e vëzhguesve të KShH.⁴²

● Rregullshmëria e procedurave të votimit

Në tërësi, sikurse është përmendur në krye të këtij raporti, KQV-të respektojnë procedurat e votimit për zgjedhësit dhe u vu re një ndarje e roleve midis tyre sa i takon respektimit të detyrimeve të parashikuara në nenin 40 të Kodit Zgjedhor dhe në Vendimin nr. 22 i Komisionit Rregullator, dt. 20.04.2023, “Për Miratimin e Udhëzuesit të Punës për

akredituar, Përfaqësuesit e akredituar të medias, Punonjësit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ); dhe Anëtarët e komisionit të zonës së administrimit të zgjedhjeve (KZAZ).

³⁷Bashkia Durrës (QV 1429,1430,1430/1); QV 2099, QV 1828/02 dhe 1829/00, 1937, 1830/1,1905, 2085/00, 1830/1, 1894, 1804/00, 1891/01, në Bashkinë Tiranë, QV 0745/02 në Bashkinë Lezhë, QV 2307 në Bashkinë Elbasan; QV 4246/1 në Bashkinë Gjirokastër; QV 3684/00 në Bashkinë Korçë; QV 4493 në Bashkinë Vlorë, QV 1592/00, 1596/01 dhe 1574 në Bashkinë Kamëz;

³⁸ QV 3273 në Bashkinë Berat; QV 3900/00 dhe 3885/03 në Bashkinë Pogradec; QV 3669/1 në Bashkinë Korçë;

³⁹ Në Bashkinë Berat në QV 3273, 3273/1 dhe 3273; Në Bashkinë e Fierit QV ,3020/00, 3032/00, 2983/00;

⁴⁰ QV 0737 në Bashkinë Lezhë, QV 2307 në Bashkinë Elbasan,

⁴¹ QV 0737 në Bashkinë Lezhë

⁴² Në Bashkinë Korçë QV 3669/1; Në Bashkinë Gjirokastër QV 4246/1; Në Bashkinë e Kukësit QV 0636/00;



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Komisionet e Qendrave të Votimit për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore*⁴³, sa i takon verifikimit të emrit të zgjedhësit në listë, kontrollit të mjetit identifikues ID, nënshkrimit të zgjedhësit në listë, timbrosjes në gishtin e madh të njëjës dorë dhe dhënies së dy fletëve të votimit të vulosura nga mbrapa me dy vula ishin të rregullta. Sa i takon timbrimit, në disa QV u konstatua se ai realizohej në gishtin e madh të dorës së djathtë dhe jo në atë të dorës së majtë⁴⁴, apo nuk realizohej timbrosja e votuesve⁴⁵ sikurse parashikon neni 105,1/b i Kodit Zgjedhor.

Fenomeni më flagrant i vënë re gjerësisht gjatë këtij procesi zgjedhor ishte komunikimi konstant i operatorëve të pajisjes PEI dhe në mënyrë të veçantë Komisionerëve të QV me vëzhguesit partiakë. Komisionerët i raportonin me zë të lartë vëzhguesve partiakë, numrin rendor të zgjedhësve, gjatë kohës që ata votonin. Ky informacion mbahej shënim nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore në aplikacione në celularin e tyre apo formate tabelare. Në Bashkinë Tiranë⁴⁶ dhe Bashkinë Elbasan⁴⁷, është vënë re përdorimi i këtij aplikacioni nga vëzhguesit partiakë. Gjerësisht, pranë Bashkisë Tiranë⁴⁸, Bashkia Lezhë⁴⁹, Bashkia Kukës⁵⁰, Bashkia Kamëz⁵¹ është vënë re siglimi i numrave rendorë të votuesve pas shfaqjes për votim në fletë të printuara me numrat nga Pajisjet PEI. Gjithashtu, fenomeni i dokumentimit të identitetit të zgjedhësve me anë të numrave të tyre rendorë, në disa raste, është konstatuar të ndiqej me lista të printuara të zgjedhësve nga grupime njerëzish (punonjës të administratës apo simpatizantë të partive) që qëndronin përbri godinave ku ishin vendosur QV-të.

i. Ndihma e dhënë zgjedhësve që nuk votojnë vetë dhe rastet e evidentuara të votimit familjar.

Raste sporadike të votimit familjar janë konstatuar gjithashtu në Bashkinë Lezhë⁵², Bashkinë Malësi e Madhe⁵³, Bashkinë Elbasan⁵⁴, Vlorë⁵⁵, Berat⁵⁶, Kukës⁵⁷, Pogradec⁵⁸, Dibër⁵⁹, Kamëz.⁶⁰

KShH vuri në dijeni KQZ për disa nga rastet e votimit familjar ose të mosrespektimit të procedurës për dhënie e ndihmës ndaj zgjedhësve me aftësi të kufizuara që nuk votojnë dot vetë, të cilat krijuan dyshime të votimit familjar. Këto problematika sistemike (të përsëritura)

⁴³ Pjesa III: “Anëtarët e KQV janë përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në QV dhe zbatojnë detyrat e përcaktuara me Vendim të KQV në funksion të mbarëvajtjes së zgjedhjeve në QV”

⁴⁴ QV 1645/01, QV 1813/02

⁴⁵ QV 2073, QV 2090/00,

⁴⁶ QV 1827/1, 1827/2

⁴⁷ QV 2376, 2377

⁴⁸ QV 1827/1, 1827/2, 1830/1, 1827/2

⁴⁹ QV 0734/0, 0737

⁵⁰ QV 0652/00

⁵¹ QV 1571/01

⁵² QV 0737 2 raste, QV 687;

⁵³ QV-0025

⁵⁴ QV 2322, tre raste

⁵⁵ QV 4459

⁵⁶ QV 3273; QV 3311

⁵⁷ QV 0648/00

⁵⁸ QV 3885/03

⁵⁹ QV 1142; QV 117

⁶⁰ QV 2074/00; QV 1569/01; QV 1572; QV 1598



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

janë vërejtur edhe në zgjedhjet e kaluara. Shqetësues është fakti që Komisionerët e QV nuk shfaqën njohuritë e nevojshme për parandalimin e rasteve të votimit familjar apo dokumentimin përkatës të rasteve të dhënies së ndihmës ndaj zgjedhësve që nuk votojnë dot vetë, konform detyrimeve që burojnë nga neni 108 i Kodit Zgjedhor.

Gjatë verifikimit në terren në Bashkinë Tiranë, janë konstatuar një sërë rastesh të dhënies së ndihmës ndaj familjarëve, me arsyetimin se nuk votonin dot vetë, të cilat krijuan dyshime të votimit familjar. Në QV 2061/00, pjesë e ZAZ nr. 30, nusja e djalit ndihmoi vjehrrën e saj të moshuar të votojë, por nuk u respektuan procedurat e parashikuara në nenin 108 të Kodit Zgjedhor. E njëjta situatë është konstatuar edhe në një sërë QV të tjera, të ngritura në zonat periferike të Njërive Administrative pjesë e Bashkisë Tiranë.⁶¹ Në një rast është tentuar që për një shtetas që nuk voton dot vetë, fletët e votimit janë marrë nga personi që ka nënshkruar deklaratën dhe janë plotësuar nga dikush tjetër⁶². Në territorin e së njëjtës Bashki, janë konstatuar raste të personave që ndihmojnë familjarët e tyre të votojnë, por shënimet në librin e protokollit administrohen pas realizimit të ofrimit të asistencës në votim⁶³ në çënim të nenit 108 pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Ndërkohë, u konstatuan KQV të cilat edhe pse në kushtet e dallueshme të aftësisë së kufizuar të zgjedhësit, krijuan vonesa apo nuk kishin infrastrukturën e nevojshme për të lehtësuar votimin e tyre⁶⁴. Në disa QV të Bashkisë Tiranë, problematik ka qenë fakti që ka patur një numër të lartë votuesish të moshës së tretë, të cilët kanë patur nevojë të asistohen për të votuar. Në këto ZAZ është parë nevoja të improvizohet shtimi manualisht i numrit të deklaratave, për shkak se në librin e protokollit ka patur një numër të limituar formatesh⁶⁵.

Rastet kur vëzhguesit raportuan se janë respektuar detyrimet e nenit 108 të Kodit Zgjedhor i përkasin një pjese të QV të monitoruara në bashkitë Gjirokastër⁶⁶, Korçë⁶⁷, Fier⁶⁸ dhe Pogradec⁶⁹.

ii. Fshehtësia e votës

Nga vëzhguesit e KShH janë evidentuar raste sporadike kur votuesit kanë cenuar parimin e fshehtësisë së votës, duke palosur fletën jashtë dhomës së fshehtësisë⁷⁰, duke fotografuar

⁶¹ QV 2110; 2074/00; 1895/00

⁶² QV 639/00, ZAZ Nr. 29, pranë së coles u vu re se anëtarët e KQV-së, në kundërshtim me nenin 107 të Kodit Zgjedhor, nuk i vendosin këto fletë tek ato të dëmtuara, por realizuan mbi to shënime duke i hedhur më pas në kutinë e votimit.

⁶³ QV 2052/01 ZAZ 30;

⁶⁴ Në QV nr.3311, në Bashkinë Berat, për një zgjedhëse në moshë të re, me probleme të shëndetit mendor, Kryetarja e KQV-së nuk e lejoi të ëmën për ta ndihmuar, pasi nuk kishte raport mjekësor dhe vetëm pasi ajo shkoi dhe e mori, e më pas paraqiti në KQV, u kryen procedurat për dhënien e ndihmës konform Kodit Zgjedhor. Po në këtë QV, një zonjë me aftësi të kufizuara të shikimit është ndihmuar të votojë nga djali i saj pasi nuk ka pasur fletë të posaçme votimit. Procedurat e dhënies së ndihmës u respektuan pjesërisht nga KQV.

⁶⁵ QV 2055/00, QV 2092/00

⁶⁶ QV 4236, QV 4262/1

⁶⁷ QV 3676

⁶⁸ QV 3191; QV 2994/1

⁶⁹ QV 3891/00

⁷⁰ ZAZ 74 QV 3683, Bashkia Korçë; ZAZ 37 1907/00, Bashkia Tiranë



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

votën⁷¹ apo duke tentuar ta fotografonin⁷². Fotografimi i votës i ngarkon me përgjegjësi penale zgjedhësit në bazë të nenit 327 K. Penal si dhe detyron anëtarët e KQV-së që të kërkojnë ndërhyrjen e oficerëve të policisë, për të garantuar fshehtësinë e votimit. Pas këtyre incidenteve, në disa QV është ndjekur praktika e mos lejimit të telefonave në Qendrën e Votimit nga ana e KQV-së.⁷³ Ndërkohë në një qendër tjetër votimi⁷⁴ fotografimi i votës është deklaruar se nuk është vërejtur nga Komisionerët e QV. Lidhur me këtë rast, vëzhguesja e KShH ka depozituar një vërejtje me shkrim pranë komisionit, e cila nuk u mor parasysh.

Sikurse është përmendur edhe më herët, vëzhguesit kanë raportuar raste të mundësisë së identifikimit të zgjedhësve nëpërmjet dhënies së informacionit nga operatori i PEI ndaj vëzhguesve partiakë, konkretisht numrin rendor të zgjedhësit. Këto të dhëna janë pasqyruar nga vëzhguesit partiakë në aplikacione të dedikuara në celular⁷⁵ ose në mënyrë manuale në blloqet apo formate tabelare të printuara⁷⁶. Raportime të tilla mbartin potencialin e rrezikut për inditimidimin e zgjedhësve që vendosin të mos votojnë apo influencimit ndaj tyre, për shkak të identifikimit që mundëson numri rendor ndaj zgjedhësit në listën e zgjedhësve.

● Mbyllja e procesit të votimit

QV e monitoruara nga vëzhguesit e KShH-së u mbyllën në kohë, në orën 19:00 sikurse parashikohet në nenin 11 pika 1 të Kodit Zgjedhor. Problematikat e përsëritura nga zgjedhjet e kaluara, sa i takon kësaj faze të procesit, kanë të bëjnë me konfuzionin dhe paqartësitë e krijuara tek Komisionerët e QV, për veprimet procedurale që duhet të kryenin për dokumentimin e procesit dhe vendosjen e materialeve zgjedhore në kutitë e votimit, sipas nenit 112 e vijues të Kodit Zgjedhor. Atmosfera e mbylljes së QV ishte e qetë dhe pa incidente, pasi nuk pati zgjedhës në radhë që kërkuan të votonin dhe që ju refuzua votimi në orarin zyrtar të mbylljes së QV.

Në disa raste, vëzhguesit e KShH-së nuk janë lejuar ose penguar për të monitoruar procedurat e mbylljes së QV nga ana e Komisionerëve. Konkretisht, në QV nr. 3273 (ZAZ 65) Bashkia Berat, pas mbylljes së votimit, sekretari i kësaj KQV-je i ka kërkuar të gjithë vëzhguesve, përfshirë edhe vëzhguesen e KShH-së, të dalin jashtë qendrës së votimit duke mos i lejuar të jenë vëzhgues të procesit të mbylljes së votimit. Pas rezistencës së vëzhgueses së KShH për të dalë nga QV, disa anëtarë të kësaj KQV-je kanë kërkuar brenda QV prezencën e policit i cili do të shoqëronte kutitë e votimit drejt KZAZ-së përkatëse, i cili nuk ka ndërhyrë në këtë proces. Në vijim, pas vonesës për nisjen e procesit të mbylljes së votimit, KQV-ja e ka nisur këtë proces në praninë e vëzhguesve (përfshi vëzhguesen e KShH-së). Për këtë rast, është vendosur në dijëni edhe KQZ⁷⁷.

⁷¹Bashkia Vlorë ZAZ 84 QV nr. 4459; Bashkia Dibër ZAZ 19 QV 1142;

⁷²Bashkia Kukës ZAZ 11, QV 0645

⁷³Bashkia Kukës ZAZ 11 QV 0645

⁷⁴Bashkia Dibër ZAZ 19 Në QV 1142

⁷⁵ZAZ 49, QV 2376, 2377 pranë Kopshtit Soros në Bashkinë Elbasan

⁷⁶Në ZAZ Nr.29, ne QV-Nr. 1633/00 Bashkia Elbasan; ZAZ 29, QV 2073 Bashkia Tiranë; QV 0737, ZAZ 12 Bashkia Lezhë; ZAZ 86 QV 4490 dhe 4491/01 Bashkia Vlorë; ZAZ 11 QV 0652/00 Bashkia Kukës;

⁷⁷Gjatë procedurave të mbylljes së votimit në këtë QV, vëzhguesja e KShH-së raporton se nuk është respektuar neni 113/6 i Kodit Zgjedhor, sipas të cilit, origjinali i Procesverbalit për Mbylljen e Votimit futet në kutinë e



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në Bashkinë Tiranë, si rrjedhojë e kombinimit të alternuar të identifikimit manual dhe elektronik të zgjedhësve gjatë votimit, nëpërmjet pajisjes PEI, u krijua konfuzion midis Komisionerëve pasi nuk përputhej numri i zgjedhësve në listën e printuar dhe numri i fletëve të papërdorura, sipas procedurave të parashikuara në nenin 113 të Kodit Zgjedhor⁷⁸. Problematika u vërejtën edhe pranë QV-së 1833 dhe 1827/2 (Bashkia Tiranë), tek të cilat, komisionerët shfaqeshin të paqartë për procedurat që duhet të ndërmerren, sa i përket plotësimit të procesverbaleve dhe librit të protokollit dhe administrimit të tyre brenda kutisë apo mbajtjes jashtë saj, si dhe procedurën për dorëzimin e materialeve pranë GNV⁷⁹. E njëjta situatë u shfaq pranë QV-së 0650/00, Bashkia Kukës, ku nisja e kutisë pranë VNV u realizua vetëm në orën 19.54, pas konsultimit gjatë veprimeve të mbylljes, të Manualit përkatës të KQZ.

Makinat shoqëruese të të gjithë bashkive të monitoruara shfaqeshin pa logo evidentuese të KQZ-së, të cilat të tregojnë qartësisht që mjetet po përdoren për të transportuar materiale sensitive zgjedhore. Edhe pse Kodi Zgjedhor nuk e përcakton këtë karakteristikë në mënyrë specifike, transportimi i materialeve zgjedhore vlerësojmë se, në parim, duhet të jetë një proces tërësisht transparent dhe i sigurtë për të garantuar integritetin e vullnetit të shprehur të votuesve.

- **Numërimi i votave**

Pas mbylljes së procesit të votimit për zgjedhjet lokale të 14 Majit 2023, vëzhguesit e KShH-së vijuan monitorimin pjesërisht të procesit të numërimit në 9 VNV, të vendosura pranë godinave të KZAZ-ve, në 7 Bashki të vendit, përkatësisht në Berat, Lezha, Malësi e Madhe, Tiranë, Vlorë, Korçë, Pogradec dhe Elbasan.

Në orët e para të mëngjesit, procesi i numërimit rezultoi i përmbyllur totalisht vetëm në Bashkinë Kamëz, e cila pilotoi votimin dhe numërimin elektronik. Ndërkohë në Bashkitë e tjerë të vendit ka qenë e mundur mbyllja e pjesshme e tij.

Janë konstatuar zëvendësime të anëtarëve të GNV-ve, gjatë fillimit të procesit nga lista e anëtarëve të propozuara nga subjektet politike PD dhe Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, si dhe ndryshimet e rënditjes së GNV-ve në tavolinat e numërimit nga subjekti zgjedhor PS, në VNV 01 të Bashkisë Malësi e Madhe.

Bazuar në problematikat që ka shfaqur ky proces në këtë kaluarën, KShH vlerëson pozitivisht Urdhërin nr.71/2023 të orëve të para të mëngjesit të datës 15 Maj të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për mosndërprerjen e tij, duke urdhëruar KZAZ-të në vend të marrin masat për zëvendësimin në kohë të anëtarëve të grupeve të numërimit të votave nëse është rasti, si dhe të zhvillojnë procesin e numërimit të votave për kandidatët për kryetar të bashkisë dhe të këshillit bashkiak në mënyrë të pandërprerë.

votimit, e cila vulolet menjëherë me kodin e fundit të sigurisë, ndërsa kopja futet në kutinë e materialeve të votimit, e cila më pas vulolet me kodet përkatëse të sigurisë.

⁷⁸ QV 1827 (ZAZ 35)

⁷⁹ KQV-ja 1833 u konsultua me KQV-në ngjitur, ndërkohë që 1827/2 vijoi konsultimin me Manualin e dorëzuar nga KQZ hap-pas-hapi me procesin e mbylljes



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ashtu siç është evidentuar edhe gjatë procesit të votimit edhe në vendet e numërimit të votave është konstatuar në disa raste, prezenca e personave të paautorizuar në brendësi të ambientit të VNV-së. Kjo situatë është raportuar në VNV 69, në Bashkinë Pogradec, si dhe në VNV-të 12 dhe 13 të Bashkisë Lezhë. Vendosja në formë të dukshme e bexhave të akreditimit respektohet vetëm nga ana e vëzhguesve të organizatave jofitimprurëse vendase apo atyre ndërkombëtare.

Gjatë orëve të para të procesit të numërimit, nuk janë vërejtur kontestime nga anëtarët e GNV-ve lidhur me procesin e deri atëherëshëm, ndërkohë që ka patur të tilla nga vëzhguesit partiakë të vendosur pranë VNV-së nr. 69, Bashkia Pogradec si dhe në VNV-ve 12 dhe 13 në Bashkinë e Lezhës..

Në VNV 11 në Bashkinë Kukës dhe VNV 13 në Bashkinë Lezhë është konstatuar pezullim i procesit të numërimit të votave deri në një kohë prej 2 orësh, për shkak të tensioneve të krijuara mes vëzhguesve të subjekteve zgjedhore dhe grupeve të numërimit apo për shkak të shënimeve të evidentuara në fletët e votimit ose vulat e vendosura në fletët e votimit, nuk kanë qenë të dukshme, sipas kërkesave të nenit 117, pika 3, gërmat b) dhe c) të Kodit Zgjedhor. Pas ç'tensionimit të situatës, procesi ka rifilluar normalisht.

Në tërësi, në raport me zgjedhjet e kaluara, KSHH vlerëson ritmet e shpejta të procesit të numërimit. Sipas të dhënave të publikuara nga KQZ deri në orët e pasdites, rezulton se procesi i numërimit për kryetar bashkie ka përfunduar në 42 nga 64 bashki të vendit⁸⁰. Ndërkohë, numërimi i votave për anëtarë të këshillit bashkiak ka filluar pas përfundimit të procesit të numërimit për garën për kryetarë bashkie, dhe rezulton i mbyllur në 4 Bashki të vendit, Elbasan, Kamëz, Vorë dhe Pustec.

● **Veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve**

Mungesa e hetimeve të shpejta, transparente, të gjithëanshme, si dhe mungesa e ofrimit të një mbrojtje efektive ndaj kallëzuesve, janë elementë që ndikojnë besueshmërinë e qytetarëve tek organet që hetojnë krimin zgjedhor. Hetimet mbi krimin zgjedhor shtrihen vetëm në nivele të ulëta të organizimit politik. KShH vëren se kjo situatë ka ndikuar mbi qytetarët dhe mungesën e denoncimeve prej tyre.

Angazhimi solemn i Kryetarëve të partive, sipas nenit 64 të Kodit Zgjedhor, mbetet formal dhe shitblerja e votave mbetet një fenomen i cili megjithëse nuk promovohet zyrtarisht dhe publikisht nga subjektet zgjedhorë, as dënohet në mënyrë serioze prej tyre. Edhe në këto zgjedhje, KShH vëren se në tërësi, drejtuesit e subjekteve zgjedhorë paraqesin akuza të rënda për shitblerjen e votës dhe krimin zgjedhor pasi procesi është mbyllur. Qasje të tilla të heshtjes gjatë periudhës parazgjedhore dhe reagimit të mëvonshëm, kur procesi është mbyllur, vendosin në diskutim edhe integritetin e vetë subjekteve.

⁸⁰ Elbasan; Vlorë; Korçë; Berat; Kamëz; Lushnje; Maliq; Sarandë; Kuçovë; Cërrik; Patos; Librazhd; Rrogozhinë; Dimal; Vorë; Peqin; Mat; Bulqizë; Mirditë; Selenicë; Gramsh; Belsh; Roskovec; Përrenjas;Himarë; Tropojë; Dropull; Has; Përmet; Memaliaj; Klos; Kolonjë; Delvinë; Skrapar; Poliçan; Tepelenë; Pukë; Konispol; Këlçyrë; Fushë-Arrëz; Libohovë; Pustec. Rezulton të jenë numëruar 3619 kuti votimi nga 5213 në total në rang vendi.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Pak ditë para ditës së votimit të zgjedhjeve vendore të dt.14 Maj, u vërejt një fluks i shtuar të rasteve të dyshuara si shitblerje e votave në disa Bashki të vendit, të sinjalizuara kryesisht në media.

Në datën 12 Maj njëri prej kandidatëve për kryetar bashkie në Dibër, kallëzoi një rast të dyshuar të shitblerjes së votës. Edhe pse fenomeni i shitblerjes së votave, shfaqet kompleks sa i përket formave të organizimit dhe ekzekutimit, megjithatë në më pak se një ditë pas denoncimit të ngjarjes, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, me anën e një deklarate zyrtare informoi se: *“nuk ka rezultuar asgjë e paligjshme”*. Përfundimi i veprimeve procedurale, në një kohë kaq të shpejtë dhe nxjerrja e përfundimeve, mbi një kallëzim sensitiv, krijoi një praktikë të dy standartizuar në raport me rastet e sinjalizuara apo denoncuar publikisht në media, në disa Bashki të tjera. KShH i është drejtuar Prokurorisë së Dibrës me një kërkesë të veçantë për informacion.

KShH ka vijuar me vëzhgimet sistematike në terren, si dhe identifikimin dhe verifikimin e të dhënave të raportuara nga media, nga vetë gazetarët apo bazuar në sinjalizimet publike të subjekteve zgjedhore apo gazetarëve, për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Janë denoncuar në media disa raste të dyshimta të shitblerjes së votës në Bashkitë Tropojë, Has, Tiranë, Himarë dhe Mallakastër (shumica e tyre vetëm pak ditë para datës së zgjedhjeve).

Me qëllim informimin mbi masat e marra nga ana e organeve proceduese për hetimin efektiv dhe objektiv të këtyre rasteve, i jemi drejtuar Prokurorive të disa rretheve gjyqësore dhe Prokurorisë së posaçme (SPAK), me 5 kërkesa zyrtare për informacion, nëse ka filluar apo jo procedimi penal lidhur me to, me kallëzim, referim apo nismën e tyre. Vlen të theksohet se informacioni që organet proceduese ndajnë me publikun është minimal dhe vërehet një qasje jo e unifikuar nga prokuroritë kompetente në këtë drejtim. Komunikimi i kufizuar dhe i dy standartizuar në raport me publikun, krijon premisa për keqinterpretim të fakteve nga palët e treta, sa i takon natyrës selektive të procedimeve penale.

Në konferencën për mediat të datës 12.05.2023 të Policisë së Shtetit u bë e ditur për publikun se gjatë periudhës 14.04.2023 deri më 12.05.2023, janë evidentuar gjithsej 54 raste të veprave penale në fushën e krimeve zgjedhore, për të cilat janë proceduar penalisht gjithsej 88 shtetas. Një numër i tillë procedimesh rezulton të jetë shumë i ulët. Kjo e vlerësuar në raport me shkallën e perceptimit që kanë qytetarët për krimet zgjedhore, referuar kontakteve që ne kemi patur me zgjedhësit në terren. Vlen të theksohet se ndarja e të dhënave të tilla nga Policia e Shtetit, në pjesën fundore të periudhës kur referohet se janë bërë kallëzimet është e vonuar. Rrjedhimisht, ky informacion nuk i shërben qasjes sistematike të transparencës dhe as nxitjes denoncimeve që ndihmojnë për të ç’rrenjosur kulturën e pandëshkueshmërisë së veprave penale që cenojne zgjedhjet e lira e sistemin demokratik të vendit.

Të dhënat për këto vepra penale vijojnë të jenë ende në proces përpunimi sasior dhe cilësor, por në tërësi KShH vlerëson se hetimi i krimit zgjedhor nga organet proceduese është shumë i vonuar në kohë. Gjithashtu, mungojnë kryesisht rastet e ndjekura me iniciativën e prokurorisë, ndërkohë që sikurse dihet, organizimi i subjekteve zgjedhore për procesin parazgjedhor nis shumë muaj më parë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në përfundim, KShH vlerëson se vetëm në sajë të hetimeve pro aktive, të plota e të gjithëanshme, objektive dhe jo selektive, të shpejta në kohë sa i takon veprimeve të ngutshme procedurale, **veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve** do të hetohen e ndëshkohen në mënyrë efektive, duke kontribuar në parandalimin e tyre të posaçëm dhe të përgjithshëm.